

Hamza Minarolli

copëza

jete



HAMZA MINAROLLI

C O P E Z A

J E T E

(Vjersha)

SHKALLA E SUEU II
GJERGJ KOCHEVI
3105
13633

shkallë e sëmundjeve
dëshmorët e përgjithshme e veshur
në këtë shkallë rrethohet
si një zogja, qenësi i mungosur

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1964

ELBODA VENI ANAMAK

Г О Р Й О
С Т В Е

(одинадцать)

Redaktor: Halil Qendro
Korektore letrare: Neka Turkeshi
Piktore: Dolli Gjinali
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-55

Shtyp. N. L. Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

COPËZA JETE

E madhe ështëjeta, pa an' e pa kufi
Dhe ëndra ka në të,urrejtje, dashuri....
Dh'e vrazhdët ësht' ajo, ësht' det plot me stuhi,
Po prapë ësht' m'e dashur se çdo lloj dashuri.

Un' erdha si të tjerët, dhe pashë kësaj jete
Si lind një dashuri, si ndizet një urejtje...
Dhe si në ëndërime gëdhinen kaqe nete
Dhe mblodha, ja kështu, tinguj copzash jete.

KOMBITATIM

Dhe kur flakës të vërvitën,
Dhe kur shpatat të qëlluan,
As të vran', as të zhuritën,
As të heshtën, as të shtruan.

Se te zemr' e robëtuar,
Zemr' e djegur për liri,
Xix' e shpresë nuk qe shuar,
Ajo ndiste zjarr në gji!

A T D H E U T

Mëngjesi zbardh dhe zgjohem unë
Dhe botën përshëndes,
Por nga kjo botë, i them së pari
Atdheut mirmëngjes!

Gjith' ditën un' jetoj me të
Dhe shpesh ne kuvendojmë,
Por fjalët tona janë pa zë
Në zemër gurgullojnë!

Kur nat' e vonë thërret në gjumë
Me botën përshëndetem,
Po me atdhenë s'kam të ndarë,
Dhe fjetur me të mbetem!

KUJTIME LAVDIE

(Në Krujë)

Ngado që hedh vështrimet me mure ësht'
mbështjellë.
E muret, nër themele, kan' gurë prej graniti,
Këtu shikoj lavdinë, që fshihet në kështjellë,
Ku Mbreti ynë i Madh shqiponjat vite prijti.

Dhe prap për të mendoj, por syr' i fantazisë
Kam frik' se m'a gabon të gjithë madhështinë,
(Që ruan kjo kështjellë, për vitet e lavdisë),
Ku burrat si virtute kan' nderin, trimërinë.

Shikoj edhe Sulltanët tek rrjinë të vrerosur,
Ndigjoj dhe trokn' e kalit që sillet në kështjellë,
Dhe sipër atij kali, ky Mbret' i armatosur,
Më ngroh, me afshn' e tija, në zemrën time thellë.

TETË NËNDORI

C'ësht' kjo drit' e c'ësht' ky diell
Që agon në këtë ditë?
Ne jetuam sa ky qiel
Po nuk pamë kaqe dritë!

C'ësht' ky gaz që mbulon dhenë?
C'dit' e pritkan Shqipërinë?
Nata fle, por natën s'flejnë
Një grusht trimash pér lirinë!

Pse pa gjumë rri hafia?
Malet pse më s'kan qetsi?
Thonë lindi sot Partia,
Që sjell gaz e sjell liri!

NETË ILEGALE

(Kujtimit të shokve ilegalë)

Sa her', o vellezër, gëdhitë
Netë të tëra pa gjumë,
Se dita ju duhej pér pritë,
E puna e madhe qe shumë.

Sé bazat që mali kërkonte
Pér shokët me plagë që vinin,
Hafija, që rreth ju përgjonte,
Tër' natën pa gjumë ju linin.

Pa depot që hidhnit në erë
Aksionet e shumta, pa numër...
Mjekimet, traktet, korierë...
Nuk donin sy të përgjumur.

Dhe prapë, o nat' ilegale,
S'ju trembe hordhis' me tabore
Ti ritmin tënd nuk e ndale
Dhe vdekjen pse ndeshje çdo ore.

IKËN SHOQET, IKËN !

Ikën, shoqet, ikën
Malit se ç'më vanë,
Ikën dhe s'më pritën,
Rrëmbyen dogranë.

Ikën dhe më lanë
Të rritem dhe ca,
«Je e vogël» më thanë
S'bëkam për dogra.

Dale, moj, më prisni
Pas do t'ju gjurmoj,
Juve, moj më vrisni
Po të mos luftoj!

Dale, moj, më merrni
Nër male, në çetë,
Juve të më therni
Po s'u bësh me fletë!

PARA VDEKJES

Sa her' me vdekjen, trimi kish takuar,
Kérbaç' e spica vërviteshin mbi të
Kjo bot' çuditej se si i pat duruar,
E si prej tij s'u ndie asnje zë!

«Tregona shokët dhe jetën po ta falim!»
Gjithmon' i patën thënë atij trimi,
Ai me gisht tregonte vetëm malin
Dhe syt' i ndritnin, qeshnin nga gëzimi!

K O R I E R I

(*Balladë*)

Ulërin kjo suferinë
Maleve po qan
Përmes saj si vetëtimë
Korieri çan.

Ka dy ditë që s'ka ngrënë
Dy net ka pa gjumë
Vetëm ik' e çan përmes
Mal' e breg e lumë...

Vetëm ik', e ikj' e tija
Duket s'ka të sosur
Dhëmbkën, lodhjen dhe urinë
Thell' i ka varrosur.

Vallë thua të jet mpirë
Trup' i tij i njomë?
Apo vallë gjoks' i tija
Nxë një qiell firomë?!

Bor' e akulltë ka ngrirë
 Ndënë të kërcet
 I ngjan zhurm' e kërkëritjes
 Si një zë që flet.

Ndjen sikur i flet eëma
 Që nga vatr' e shuar'
 «Bir, nga sytë po më dukesh
 Lodhur dhe urtuar!

Bir, këpucët pa tabane
 Shkelkan mbi dëborë,
 Bir' i nënës ti je lodhur
 Çlodhmu nja dy orë!...»

«Lashë shokët të rrëthuar,
 Shokët duan ndihmë,
 Nëm sërishmi nën' bekimin
 Nxitmë, nënko, primë...»

Ai ecte gjith përpëra
 Zog në tramundanë,
 Prapa tija, ato këmbë
 Gjurma gjaku lanë.

ËNDRAT PARTIZANE — KËNGËT PARTIZANE

Ëndrat partizane,
Këngët partizane,
Gjumë nuku njihnin,
Gjumi nuk i merrte
Nga marshim' i gjatë.

Ëndrat partizane,
Këngët partizane,
Bridhnin nëpër male,
Suleshin xhadeve,
Buz' për buz' me vdekjen
Putheshin çdo ditë.

Ëndrat partizane,
Këngët partizane
Çelën porsi lulet,
Çelën në çdo prak
Njomurë me lotë
Mbrujturë me gjak.

Ëndrat partizane,
Këngët partizane
Ç'u rritën me ditë,
Ç'u rritën me orë,
Që liris' t'i bëheshin
Dafin' e kurorë

Endrat partizane,
Këngët partizane,
Në emër të jetës
Me vdekjen përleshur,
Si e mposhtn' atë
Na dhan' aqe gas,
Na dhan' aqe jetë
Sa s'e thot dot kurrë
Kjo këngëz' e zbehtë.

PJESË FËMIJRIE

Ne na iku fëmijria,
Na rrëshqiti nëpër duar,
Gjith' e mbushur tym baruti,
Gjith' nga krisma, neve zgjuar.

Ne na iku fëmijria,
(As gëzuam, as lodruam),
Nëpër sheshet e qytetit
Ne të vrarët numëruam.

Në gërmadha duke lojtur
Ne na iku fëmijria.
Se e dogji vendthin tonë
Një major nga Italia.

Ne na iku fëmijria
Nanuritur ndër vajtime,
Numëronim ne çdo ditë
«Ja dhe kjo mbeti jetime!»

Ne na iku fëmijria,
Rrugëve si muhaxhirë,
Ku kafshatën si lëmoshë
E kërkuam të mërdhirë.

Por mes kujesh e vajtimesh
Pamë tek po fekste fari,
Pastaj fort një zë buçiti:
«Dalngadal' po vjen behari...»

KËNGË E PAMBARUAR

(Partisë)

Të ndjej në gjakun tim që gurgullon,
Të ndjej tek më rreh fort në kraharuar,
Edhe pse zemra gjith' për ty këndon
Ti prap' më mbetesh këng' e pambaruar!



D E S H I R E

Un' njerzit i dua të jenë të qeshur
E këngës t'ja thonë gjithnjë, pa mbarim,
Të çelura zemrat dhe krahët përveshur,
Qëjeta t'u rrjedhë tër vrull' e gëzim.

Dhe këngët e mijë i dua të jenë
Dhe fllad' e ballsam, barut e shkëndijë,
Nër to, si nër krojet, njerzia të venë
Dhe gazin dhe forcën prej tyre të pinë!

TË AGOJNË DIEJT

Dola me mëngjes, dielli pa aguar,
Në një stol u ula bashkë me mendimet,
Unë që kam parë diellin perënduar,
Ndjej më tepër gas të sodis agimet.

A s'është m'i bukur ky agim' i diellit
Që botën e zgjon dhe zhduk errësirën,
Që për thjeshtësim xhvesh stolit' e qielli.
Dhe ja këthen tokës dritën, ngrohtësirën?

Dua veç agimet, kur agojnë djejt,
Diejt kanë zjarrin, dritën jetësore...
Ata çajnë rrugët thellë nëpër qiej,
Ata zbuksurojnë jetën tokësore.

PËR GJIGJE

Ju profesorë të Sorbonës dhe Renës,¹⁾
Që paski stil të bukur në të shkruar,
Vall' dhe në katedër mbani ju leksione
Ashtu siç shkruani librat, pa menduar?

Për cilën Shqipëri, ju pyes, «messieurs»
Më flisni ju në tekst të gjeografisë?
Unë jam shqiptar dhe me ç'kuptova:
Ju njihni vetëm koh'n e «pellasgjisë»

E un' leksion nuk do t'ju mbaja,
T'ju them se ç'është gjeografia,
Veç, o «messieurs», e ndjej nevojë
T'ju them se ç'është Shqipëria:

II

S'ësht' fis' e klan, por shtet sovran,
Dyfish në numër nga ç'thoni ju,
Për çudi tuaj dhe institute,
Konservatore ka këtu.

1) Alber Demanzhon (Prof. i gjeografisë në Sorbonë) dhe Andre Majnie (Prof. në fakultetin e letërsisë në Ren) në Kursi i Gjeografisë Demanzhon «Europa» kl. IV, botim Hashet 1960 (faqe 99), ndër të tjera flasin kështu për vendin tonë:

«...Aty jeton një popullsi myslimanë e grupuar në tribu dhe në klane, që janë në aleancë ose në armiqësi me njëri tjetrin. Zhvillohen skena të hakmarries... Gati gjithë popullata merret me bujqësi dhe blegtori...».

Vërtet ka male dhe fusha plot
Ka edhe bujq edhe blegtore,
Veç aq sa dje kish pendë që
Sot ka kombajna dhe traktorë.

Po ju «messieurs» nuk ditki shumë,
E unë s'di ç' t'ju them më parë,
Se jan' aq shum' ato që kemi
Se na u deshën tre pesvjeçarë.

Dhe kombinate kemi ne,
Mos u çuditni! Kemi uzina,
Neonët ndritin mallrat tonë,
Aq të panumërtë, nér vitrina.

Dhe nëntokën e kemi ar
(Prej saj «messieurs» çfar nuk qisim)!
Pra, si harruat që me bitum
Ju asfaltuam ne Parisin?

Dhe rrugët tonë i asfaltuam
Pallate ngremë ndërtojm' qytete
(Po, meqë ju s'doni t'i dini!)
S'ka gjë «messieurs» i ruajm' për vete.

Për çudi tuaj midis nesh
Janë Rodeni edhe Bizeja,
Me ne çdo ditë kuvendojnë
Volter, Balzak e Merimeja...

Edhe Kyrinë e madh e njohim
Në shkoll' e jetë e citojmë,
Pa dim' më saktë se sa juve
Dhe Komunarët t'i gjykojmë.

Po ju «messieurs» vërtet kaq dini?
Vall s'e mësuat që ne jemi
Një vënd i lirë dhe socialist?
Edhe këtë ne t'jua themi?

DËSHËRONJA

Kur er' e marrë përkul lisat
E shkrep rrufeja përmbi ta,
Njérin e djeg, po tjetri rritet
Gjithmonë la edhe më la.

Edhe un' si lisi do dëshiroja
Përball' stuhive të shkoj përpjetë
Kështu dhe n'u djegsha nga rrufetë
Tek rrënjt' e mijia do mbetet jetë!

MË FAL' O NËNË E DASHUR

Më fal, o nën' e dashur, falmë mua
Që syt' e tretur ty t'i lash pa gjumë,
Po ç't'i bëj shpirtit, nënko, moj, më thuaj,
Që nat' e ditë më vërshon si lumë?

Të vret ty heshtja sot, në pleqëri
E ndaj kuvend kërkon me tëtë bir,
Po zbrazja, shpirtit, nënko, do qetsi
Ndaj falmë mua, fale tëtë bir.

N E T È V E

Hera - herës frysmezimi vjen' e më rrëmbe
Natën vonë dhe sakaqe gjumin ma pérzen

«Nëno son te spaskam gjumë, ti po deshe fli...»
Nëna veç një gjë kupton: dashkam qetësi.

Vete shtrihet mun në shtrat, bën dhe sikur fle,
Vjedhuraz, ndënë jorgan, dhëmshurisht më sheh.

Dhe mendon kur shkruaj unë (nënrat veç men-
dojnë)
«Mos në pun', a dashuriçkat djalin ma mundoj-
në?...»

Pastaj heshtur mërmërit, lut më perëndinë,
I kërkon shëndet pér mua, fatin, qetësinë.

E ahore s'mbahem dot, nis sakaq e qesh,
Ajo ngrihet, rrëmbe pallton dhe cigaren ndes.

«Nuk më flihet, bir, as mua, s'të bezdis, s'të flas
Veç një gjë, po deshe thuama, se më mbetet maras

E kujt bijë qënka kjo, që s'të zënka besë?
Thuama nënës, pa që nesër bëhem vete mblesë».

Nis ta kundërshtoj, por kot, ajo besë s'zë
Se nuk di që un' po shkruaja poezi për të.

HESHTJE QË POHON

Sa keq që nëna ime nuk mundi t'i kuptonte
(Megjith' që kish dëgjuar, nuk donte t'u besonte):
Që bota ish e rrumbull, që bota rrotullohej;
Pastaj, nga «udh' e zotit» nuk donte të largohej!

Dhe sot e kësaj dite, vështir t'i mbushet koka
Që ësht' e rrumbullaktë e rrotullohet toka;
Po kur një dit' raketa nga toka vajt' në hënë
Këtë ta kundërshtonte nuk ja dëgjova zënë!

NËNA !

Nëna gjiri, nëna djepi,
Nëna zëmr' e dhëmshuruar,
Nëna syri që nuk fjeti,
Nëna loti m'i kulluar.

Nëna qielli më i kaltër,
Përmbi zemrat fuqiplote,
Përmbi emrat më e pastër,
Krijimtare e një bote.

Nëna kënga më e zjarrtë,
Nëna kënga më e ndjerë,
Nëna kulmi më i lartë
Se dhe kulmet i ka lerë.

TIM' ETI...

Babanë kujtoj: shtegtar zemërvrarë...
Kurbetin, mërgimin i dha varfëria,
Dëgjojnë sot niprit, por thon' ésh't përrallë,
Se s'panë të djeshmen që pat Shqipëria.

Baba! Shokt' e tu, që rronin mërguar,
Drejt vendit nga ikën filluan shtegëtimin,
Un' bir mërgimtari i pres i gëzuar
Se sot vendi pret, e s'nis tej mërgimit.

SI MË LINDI KËNGA E THJESHTË

Kur lijeni fle ndajnate ndënë cipën e argjendë,
Më buçet nga shpirti thellë gjith' lirisht për të një
këngë,
Më buçet kjo këng' kujtimesh ku më zgjohet fë-
mijria,
Ku vështroj tër nostalgji ato gjurmëza të mia.

Ato gjurmëza ku shkela këmbëzbathur tërë plasa,
Ku me bredhjet çamarroke dhe me gungat u
argasa,
Ku dhe ujët e lijenit si kristali i kulluar
Duke larë vrukun tim gjithënje qe turbulluar.

Pastaj prap' me fëmijrinë kacavirem nëpër pemë,
Zbres andej dhe si iriqi, nis me ngulm' e gërmoj
dhenë,
Pastaj çaj përmes dëborës, drejt kalasë përbimi
vreshthë,
Të sodis qytetin tim e të varem me koleshkë (1)

(1) Koleshkë — Një lloj slite e vogël që përdorin fëmi-jët për të shkarë në borë.

Kur vjen prilli dhe shkrin bora, vete malit për
poleska ⁽¹⁾,
Pres korrikun, kur nér ara do të mbledh kallinj
me qeska,
Pres dhe netët e janarit, kur do mblidhet gjith'
mëhalla,
Tek shtëpit' e njëri tjetrit dhe të nisë prap' përralla,

II

Kur lijeni një ndajnatë ndënë cipën e argjendë
Erdh' ma zgjoi aqë thjesht që nga shpirti këtë
këngë,
Pash' si zgjohet fëmijria nga dremitja shumvjeçare,
E si ndizet, rritet malli për ty tokë amëtare.

E ky çast do të mjaftonte, veç ky çast në këtë jetë,
Që të bindesh, se në botë si atdheu s'mund të ketë,
Ndaj kjo këngë që ma solli frymëzimi i një nate
S'ësht' veç pjes' e dashurisë, pjes' e bukurisë sate!

1) Poleskë — Agulicja, lule e verdhë që çel në ditët e para të prillit.

K U R A G O N . . .

Ja dhe yll' i fundit iku, se ç'u shojt në pambarim
Nga e zeza ngjyr të kaltër i jep qiellit ky agim,
Pastaj tuf shigjetash ari se ç'drejtohen pér në quell,
Janë gard' e pararojë, që dërgon i zjarrti diell.

Edhe malet rreth e qark zgjatin syt' e vështrojn'
diellë
Andej pas, nga Mal' i Thatë, ku i kredhur qënka
thellë,
Si e shohin përshëndeten pastaj fushën lajmërojnë
Të sodisin, pas një çasti, kur ky diell do të agojë.

Gjer ahore gjithësia nga përgjumja është zgjuar,
Sesa herë pend' e qeve nëpër brazda ka kaluar
Dhe kope' e bagëtisë kullot fushës bar të njomë
Dhe çdo bim' a lule qoftë kundërmon aher aromë.

Zgjohetjeta... fillonjeta... nis dhe këng' e pam-
baruar
Që veç gas e gjallëri të shoh' dielli më t'aguar
E pastaj t'i derdhet fushës tërë mall ta përqafojë
Ta shndërrojë gjeth' e bukë, gjith' e gjith ta be-
gatojë

Kur të vej' edhe të kridhet n'atë ujë të kulluar
Faq'e ujit gjith' shkëlqim mbi qytet ka reflektuar
E qyteti dhe liqeni një pasqyr' e përaruar
Mirmëngjes o çast' i bukur, ti je këng' e pakënduar

P E R È N D I M

Kur ka ikur vap' e ditës dhe s'ka dal' e mbrëmjes
erë,

Kur gjinkalla çamarroke gjith' e lodhur bje të flerë,
Dhe kur faqja e liqenit vjen e bëhet ngjyr' ar-
gjendi,

Kur si zgjoi sapo nis edhe gumëzhin gjith' vendi
Kur dhe dita punëtore ka arritur ndaj mbarimit
Vjen ngadal' edhe afron çast i bukur, perëndimi.

Vjen ngadal' edhe afron çast i bukur, perëndim
Kryemjeshtr i përsosur, i pashoq në pikturim
Dhe ja nis sakaje punës — penalata ngjyra ngjyra
Derdh të rrallat bukuri, që aq rrall' i çfaq natyra.
Dhe pastaj si ka qendisur bukuritë magjiplotë
Thérret flladin t'i freskojë, t'i ndez' gazin kësaj
bote.

E andej që nga katundi vjen jehon' e bagëtisë,
Këtej parqeve fillon pëshpëritj' e dashurisë,
Andej prap' një këngë vëndce pastaj bie qetësi
Këtej pista është ndezur... kërcimtarët mizëri.
E kur vjen kjo nat' e vonë, unë prapë ndjej gjëzim
Dita nesër do ket' lindje, do ket' prapë perëndim.

M A L L ! . . .

O qytet i lindjes, o vend' i bekuar
Ku shtrihet lijeni që dremit ndajnate,
Aty, pranë teje, shpesh kam ëndërruar:
Kur bridhja i vogël nëpër monopate.

Kthjelltësinë tënde kush nuk e ka parë,
O lijen' i bukur, kulluar si lot,
Le të më besojë se ti s'ke të sharë,
Nuk ma ke, pér besë, shoqin përmbi bot'.

Ti je vend bilbilash, bilbilash çapkënë,
Kroje ke të freskta, pyje me gështënja,
Atje, ndërmjet tyre zemrën e kam lënë,
Të ma përkëdhelin tufat me mëllënja.

Atje rritet rrushi, rritet edhe gruri
Rritet dhe korani, që s'gjendet në botë,
Atje, nëpër malet, thesar është guri,
Atje këng' e jetës ndihet gazmendplotë.

Bubu ç'më zu malli, malli pér vatanë,
Pér lijenë, malet... dhe pér një zallishte
Ku dëgjohen këngët që shoqet s'm'i kanë,
Këngët e rinisë, këngët pleqërishtë.

Falmë në s't'i thashë gjithë bukuritë,
O qytet' i lindjes, o vend' i bekuar,
Kjo s'ësht' këng' e fundit ku shpreh dashuritë,
Këngën më të bukur ende s'ta kam shkruar.

PEJZASH PRANVEROR

Pranvera puthi lulet një mëngjezi
Dhe puthj'e saja gonxhet shpejt' i ndezi,
Pastaj si thithën pakëz ngrohtësinë
Me mall, ato, zbërthyen bukurinë.

Dhe vashave, pranvera, me gëzim
U skuqi faq' e buzë si rubin,
Pastaj erdhi u harboi gjinë
Që trimave t'u joshnin dashurinë.

ZEMRA IME!

Barut e paskam unë zemrën time
Një «xix» kujtese atë e ndeska flakë;
Po, prap' s'ka gjë, vërshoni ju kujtime,
Me ju, kjo zemër, kurrë s'bëhet plakë!

K U J T I M E T . . .

Ej, ky varg, ky varg kujtimesh
Qënkërka i gjatë shumë
S'paska, moj, ballsam harrimesh
Ato rrjedhkan porsi lumë.

Ato rrjedhkan porsi lumë
Her' të qeta, her' plot valë
Nëpër to notokam unë
Her' i qeshur, her' i vrarë.

Janë flak' e ndezin gjinë
Me rrëmbim e me gëzim,
Ato joshin dashurinë,
Ato s'paskan perëndim!

NJË ZË MË ZGJON NGA GJUMI...

I dua netët unë, kur yjet xixëllojnë,
Nga gjumi zemrës sime kujtimet se ç'ja zgjojnë.

Se mbrëmjeve takonim tek pylli afér lumit
E rrnim, rrnim bashkë, sa vinte or' e gjumit.

Pastaj ne njeri tjetrit i thoshim «natn' e mirë!»
Por nata ish' e gjatë, nuk' kishte të gëdhirë.

Kështu kaluan vitet, që s'paskan të harruar,
Se mall' i tyre gjinë s'e lënka të qetuar.

E netëve, sa herë, një zë më zgjon prej gjumit,
Mos vallë ti më pret te pylli afér lumit?!

KUR TI FLE...

Esht' natë, vonë, qërpallat m'u rënduan,
Ti fle e qetë, në shtratin tënd je shtrirë;
Dhe në gëdhifsha un' kujtimet, që vërshuan,
Ku zgjuar ti jeton...

Ti fli!

Natën e mirë! . .

TY TË DESHA MBI TË GJITHA
DASHURITË!

Për ty rrahu zemra ime për së pari,
Endërrimet më të bukra qen për ty,
Veç për ty nga gjoksi im shkëndija zjarri
Shkrepëtinin kur t'i puthja ata sy.

Dhe, o vash si dashuria jote kurrë
Asnjë tjetër dashuri nuk qe për mua
Se nga dhëmbjet kur ankoja, shpirtin zhurë
Ma shëronin ëmbëlsisht puthjet e tua.

Në endërrat e dashurisë të përkunda,
Gjithë këngët t'i këndova një nga një,
Përmbi shtratin tënd un' bisqe lulesh shkunda,
Që pran' meje ti të rriteshe gjithnjë.

I FALEM DASHURISE

(*fragment*)

O dashuri e marrë e ditve të rinisë
I falem zjarrit tënd dhe sqotës që le pas,
Kur isha i etuar për ndjenjn' e lumtërisë
Ti erdhe më mëkove së pari breng' e gas.

I falem zjarrit tënd dhe sqotës që le pas,
Që erdhi dhe më zgjoi ndjenjë dhe gjykim
Dhe mendjes së çunakut që gjith' ishte çapras
I dhe thellim'n' e parë të rënd' e me mundim.

I falem zjarrit tënd që erdh' ma ngrohu gjinë
Me atë ndjenj' të ëmbël, të zjarrtë dhe shqetsuese,
I falem dhe për netët e gjata q'u gëdhinë
Nër qiejt më të kaltër të botës ëndërruse.

Ndaj zemra dashurisë besnikë do t'i mbesë,
Shqetsimet e ëmbla dhe dhëmbkën do t'ja dua,
Se dhe në djeg një çast si flaka e rrufesë
Ësht' edhe zjarr' i jetës që kurrë nuk u shua.

Ja pse dhe ty, ta dish, gjithçka ta fala unë
(Për dobësit që ke s'të mbroj e as të dual!),
Po veç për këtë shpirt që më vërshon si lumë
Që çastit që ma zgjuan puthjet dhe syt' e tua.

PSE HESHT. . .?

Kur të erdhi letra, pse më heshte mike?
Në të ndiste zjarri, pse kaq shpejt' e fike?
Në t'i thash' të gjitha që më mbante zemra,
Pse kërkon në heshtje të venitet kënga?

Dhe n'e hedhç në zjarr, ajo prapë s'digjet,
Se kërkon që zemra zemrës t'i përgjigjet!
Në ma mban te gjiu zemrën të ta ngrohë,
Dy rrjeshta, prej teje, pse këtë s'ma thonë?

V E T È M T I . .

Nën qipariz po qëndroj,
Përpara deti pa kufi...
Dhe dua veç të ëndëroj,
Se në çdo ëndër më del ti!

AGIMI TË THËRRET!

Zgjohu!

Mëngjesi troket përmbi dritare,
Ti ç'pret në shtrat, më thuaj, mikja ime?
Vall nanuritesh nëpër ëndërrzat mitare,
Që gjith' e vonë po puthesh me agime?

Ngreu!

Dil dhe vështro zgjimin pranveror,
Gëzimn' e rrallë, që s'fal asnje agim
Tek përkëdhel aq ëmbël flladi mëngjesor
Dhe rrezearti diell tek ngjall aq ngazëllim.

Zgjohu!

Dhe dilju para ti agimeve,
Se ik pranvera dhe vjeshta faqezbehtë
Do të qortojë për botn' e ëndërrimeve.
Pra zgjohu, mike, dhe ec si ec kjo jetë!

TË KËRKOJ TY DASHURI!

Në lëndinë tek rri shtrirë
N'atë shtrat me bar-të njomë,
Tek më deh si me magji
Kjo pranverë plot aromë,
Tek më rritet thell në gji
Një e etëshme dëshirë
Aq' e hovshme, aq' e dëlirë:
Të kërkoi ty dashuri!

Dhe kur bredh nér trotuare,
Nér vitrina kur shikoj,
Dhe kur gjendem në vetmi
Apo pistave vallzoj,
Kudo qofsha, nuk di si...
Ti s'më shqitesh thuaj fare
Si një shoqe moshatare:
Të kërkoi ty dashuri'

KUJTIMET NGA MOTET E FËMIJRISË

(Poemth)

Un' paskam lindur në prak të portës,
Se kishte nëna një goxha vjehrë,
E që t'i mbyllej goja botës,
Në pun' e sipër u dashkej lerë.

Dhe erdha unë në këtë jetë,
I that', i pakët sa një cironkë,
Por nëna prehje s'kish si të ketë,
Se s'pyet kafshata në je lehonkë.

Kafshata s'pyeti ç'ish mall, vatan...
Pa burrë nëna, pa babë mbemë,
Ai dhe neve një jet' shafran:
Kafshat' e gojës i dha kurbenë.

II

Si klloçka zogjtë rrit me thërrime,
Ashtu na rriti kjo nën' e mjerë,
Ne barkun s'ngopëm, ne s'ndjem' gëzime,
Se fati mbyllte për ne çdo derë.

Për ne e mbyllte, por tek gjitoni
Një çup' e ndiqnin me pjat' në dorë,
E gjith' sa ishin, për të ankonin:
«Të mjerët ne s'ka ngrën' një orë!»

Un' hypja manit të mbushja zorrën,
Atë e lusnin: «Çfar do për drekë?»
Dhe ec' e jak', pa mbushur orën,
I sillnin krem edhe byrekë.

Kështu, kjo botë na qe gatuar,
«Kështu na ish' e thën e zotit»:
Un' për kafshatën i dëshëruar,
Ajo e velur çdo dit' të motit.

III

Nga jet' e zymtë, nga mosh' e njomë
Sa shum' kujtime më vijn' ndër mënd:
E djeshm' e hidhur, jo shum' e vonë,
Më çon nga gjumi si plag' që dhëmb!

Ahere malit vështir' qe rruga,
E dita s'ngrysej pa një të vrarë,
Se rrotull sillej një Hasan Struga (1)
Që hakn' e botës kish dal' të marië

Mbaj mend se si një dit' pazari
Dy gryk nagantesh derdhën të shtata,
Si lis' i prerë u shtri çezmari (2)
E trebinjari pa bër' dhjetë hapa (3)

(1) Një kriminel që vihej në shërbim të kujdo për të larë hasmëritë.

(2-3) Emra të prejardhur respektivisht prej dy fshatrave të Mokrës, Çezmës dhe Trebinjës.

Cudi ahore: të gjithë ç'ishin
I madh, i vogël dridhej purtekë,
As zotin vetë frikë s'e kishin
Se sa xhandarin, me nam, Gjon Lekë.

IV

Dhe sot mbaj mend një ditë prilli
Kur rrugët tonë u mbushën plot
«Na shiti» thoshin, «Posht' katili!»
«Ne, demonstratë do bëjmë sot!»

C'të ish kjo fjalë, kjo «demonstratë»
Që dashkan burrat të bëjnë sot?
Por gjith' sa pyeta s'm'a bën' të gjatë;
«S'ësht' pun fëmijësh, mos pyet kot!»

Pastaj un' pashë bashkqytetarët,
Që mbanin flamurn' e kuq nér duar,
E çante turma përmes xhandarët:
«Na jepni armë për të luftuar!!!»

Pastaj ja merrnin «Për mëmëdhënë...»
Pastaj thërrisin: «Na shiti mbreti!...»
Pa zbriti Mokra e fshatrat ç'qenë,
Në rrug' u derdh i gjith' rëmeti!

Të ishte dasmë, kjo, dasmë s'qe!
Të ishte festë, vall ç'kishte ndodhur?
Fytyr' e turmës si quell me re
Hedh çapet xvarrë, tronditür, lodhur!...

Dhe pas dy ditësh një mizëri
E mbushi tokën an' e mbanë:
Të gjithë qënkan këmishëzi,
Të gjith' në kokë pupla kanë!

E u nxi qiali e u bë sterrë
U përzje tymi bashkë me retë,
Dhe u mbush vendi me bersalierë
Të Duçes «trima» tër' pend' e fletë!

V

Kjo turm' e huaj më dha mërzi,
Pastaj dhe gjoksit diçka më ndiste,
«Kur erdhka hasmi mun në shtëpi
I zoti, heshtur, si mund ta priste?!»

Ende s'kuptoja kush kish të drejtë:
Qytet' i tërë që qan, rënkon...
Apo «paria» që veshi shpejtë
Këmishn' zezë dhe hasmin mbron?

Ahere thuhej se vec «paria»
Ka mend në kokë dh'e di çdo bërë;
«Pra, e donte puna që vegjelia
Të gjithë barrën asaj t'ja lërë!»

Kështu «paria» aher' na fliste,
Po kundra saj u ngrit «çunaku»
Na thoshte «shokë!», zemrat na ndiste:
«Sot, për atdhenë do derdhur gjaku!...»

E këto fjalë lshuan rrënë tek mua:
C'do burr' i botës në vatrën time?
Si «Derrit-Dajo» vjen' e m'i thua?
E s'qenkam zot' i vatrës sime?...»

U rrit ky zjarr me ditë, me netë
 Me ditë e netë menduam ne:
 Se duhej pushkë, e pushk' e shkretë
 T'i merrej hasmit, për ty Atdhe!

Dhe nisi kënga dhe krisi pushka,
 Qyteti zbrazej të mbushte malë,
 I thanë hasmit: «Ku të çon mushka?»
 Pastaj me plumb i ram' në ballë.

U ngrit ahere tër vrer «paria»
 Dhe krah armikut shpalos bajrakun:
 «S'ka ardhur koha që Shqipëria
 Të marrë malet, të derdhë gjakun!...»

Pastaj vëllajt i vun' vëllanë,
 Vëllezrit tanë përkrah armikut;
 «Paria» çirrej: «ne mbrojm' vatanë
 Nga far' e keqe e bollshevikut!»

.

Ne prap s'u ndalëm, por çam' stuhisë,
 Partia prijti — marshuam ne,
 Kurban me mijra iu bën lirisë
 Që të rilindte Shqipri' e re!

E till' kaloi e djeshmjë jonë:
 Pa bukë, djegur, vrar' e prerë!...
 Kjo s'ësht' përrallë a këng'e vonë
 As krahëlehtë si kjo erë!

RINGJALLJA E NJË ZEMRE...

(p o e m ē)

I

Po mendoj e sjell ndër mend
Koh'n' e shkuar,
Kur vëllaj me të vëllanë
Pat luftuar.

Se kish bij të kësaj toke
Si ata,
Që mohuan gjakun, vendin
Për para.

Se kish bij të kësaj toke
Që s'e deshën
Kur e panë varfanjake
Zun' e qeshën.

Kur e panë robëruar
S'bënë zë,
Hasmi shtyp, e shtyp ata
Bashk' me të.

Pat' dhe bij që val' e egër
E mashtrimit
Verbërisht i rrrokullisi
Buzë krimít.

Dhe kur erdhi çast i fundit
I gjykimit
Turm' e zezë mori rrugët
E mërgimit.

Muanr' rrugët përtëj detit
Ku nuk vanë...
Lanë gratë, lan' fëmijët
Dhe vatanë.

Edhe larg në dhe të huaj,
N'arrati,
Humbën ç'patën... humbën zemër
E qetsi.

II

Zër' i radios më të mekur,
Sikur flet firom' e vdekur
Se përreth përgjon hapsana,
Kur fillon «Parla Tirana» (1)

Ai struktur dhe afruar
Njësh me radion i bashkuar,
Po dëgjon me ankth dekretin
Për ata që hodhën detin.

1) «Flet Tirana».

— Vall tē jetē e vërtetē?
Mbet pér ne mëshir' nē jetē?
Kaç bujar ësh't ky Aïdhe,
Që na fton sërishmi ne?

Apo vallë kurth' i mjerë
Kërkon zemrat tē na çjerrë
Dhe pastaj, pastaj... sa keq:
Ngec si zogu mu nē leq?!

Dhe kjo s'është kursesi!
Qysh vendoset..., prap s'e di?!
Ja besova... ç'më pret mua?
Të më duan, kur s'i dua? —

Dhe sakaq' e ndez tërbimi,
E hedh rrugve hidhërimi,
Dhe sa gota plot përplot
Dhëmbkën nuk ja shuajnë dot!

Nata nxin e shpirti sterrë,
Nata hesht e shpirti nderë,
Vetëm këmbët prijn' përpara,
Her me hov e her tē çala.

Sakaq bregut i avitet
Majë shkëmbit vete ngjitet
Dhe vështrimet tej i hedh,
Përtej detit mendja bredh...

* *

Era natën fryn ngadalë,
Lëkund detin valë-valë;
Vala-valën bregut mbrijnë
Me shkëmbijtë pëshpërijnë.

Majë shkëmbit i dërmuar,
Qëndron heshtur dhe vëtmuar,
Dhe vështron nga del kjo hënë,
Përtej detit bab' e nënë.

Dhe vështron, vështron i etur,
As i zgjuar, as i fjetur,
As i vdekur, as i gjallë,
Zemër copë e zemërvrarë...

Pastaj nis e flet përqart
Për një eshk' e një masat,
Për ca male me dëborë
Dhe për deshrit me këmborë.

Por sakaqë kabareja,
Prostitutat, ylefeja... (1)
Se ç'e ftojn' me zhurm' e bujë
Tek një botë llum, rrëmujë...

Zë e dridhet, nëmë rëndi,
Drejt përpjetë e hedh vendi:
«Kabarera, prostituta...
Me ju thellë, më thell' u futal!...»

Këtej detit — Tradhëtar!
Andej detit — Një zagar!
Mes dy brigjesh det me valë,
Zor të kridhet, zor të dalë!

Këtej detit, thon', ësht' ferri,
Andej detit buçet vreri,
Këtej, thon', pret varr' i zi,
Andej llum' e tradhëti.

(1) Rroga, paga në të holla.

Jep e merr e s'di të ndajë:
Kë të mbrojë e kë të shajë?
Kufi detesh jan' dy brigje
Që kan ndryshe jet' e ligje!

III

Netët pas nuk njohën gjumë,
Net' e ditë u bënë një,
Se vërshonte shpirti lumë,
Se dëgjonate veç një zë.

Ja bje vala, ja bje deti,
Që përtëj nga toka mëmë:
«Kush e la dhe prap' e gjeti
Shqipërinë që pat lënë?

Kush e la dhe e kish njohur
Nga fytyr' e përtërirë?
Kush nga vojtjet, zemërlodhur,
Nuk u kthye me dëshirë?

Kush e quan fjalë-bajate,
Fjalën tonë gas e jetë?
Kush ka ngritur kombinatë
Kaq të shumt' e kaqe shpejtë?

Kush e kush... e sa të tjera
Thotë me mburrije Shqipëria
Dje vajtonte — Un' e mjera!
Sot m'i ndritka vajzëria.

Edhe bijtë q'u mërguan
Prej kafshatës dhe urisë
Viin' me gas, duke vrapiuar,
Pranë zogjve, pran' shtëpisë.

Kur e panë s'folën dot,
Se gëzimi s'gjetka fjalë,
Vetëm sytë rridhnin lot'
Lotët vlenin mijra fjalë!...»

Ja këto i dëgjon veshi
Ashtu shtrirë e ashtu nderë,
Buz' e vrarë i buzëqeshi:
«Jan' për tokën ku kam lerë!»

Pastaj malli se ç'e ndezi,
Tërë natën ëndërroi;
Çap më çap, sa erdh mëngjesi,
Shqipérinë e kaloi.

Brodhi stanet, brodhi malet,
Brodhi fushat tatëpjetë
Dhe më gjat' iu desh të ndalet
Tek një prak ku erdh në jetë.

Se pa gruan, pa dhe djalin
Që i la e i braktisi,
Pa dhe rrrotull që po dalin
Një nga një i gjithë fisi.

Pa dhe vehten midis tyre,
Si një her' e si një mot,
Këtej ishte drith' e syve,
Andej filli në një botë.

Këtej ishte bab' e burrë
«Gur' i rënd' në vend të tij»,
Andej mbetur zemërzhurë,
Pa vatan e pa shtëpi.

Kjo s'e la tē vej' mē gjatë
Mes dy botash ju bē urë:
«Gdhij mē shpejt, e zeza natë,
Se m'u dogj kjo zemër zhurë!»

Pastaj mori tren' e parë
Asaj rruge... për Atje...
Që t'ju thoshte vec një fjalë:
«Nuk u rrojtkë pa Atdhe!»

IV

Rrug' i shkoi një dit' e natë
Rrug' e pambaruar,
Nga mendimet, zemr' e ngratë,
Lodhur qe, dërmuar.

Por agimi që erdh' pas
Erdh' i ngazëlluar:
Një bot' ikte, mbetej pas,
Tjetra sa aguar.

Çapn' e parë hoqi xvarrë,
Tjetrin s'ngrinte dot;
S'ish e lehtë: bot'n' e ndarë
Kapërxente sot.

Kok'n' e ulur nér mendime
Këmbët se ç'e prijnë,
Herë dhëmbje, her' gëzime
Mbi tē ven' e vinë.

Zë i flet vehtes së tija,
Fjalët s'gjejn' përgjigje!
S'ësht' e lehtë tradhëtia
Ka dhe zemra ligje.

«Mos, atje, për ku jam nisur,
Mbetem tradhëtar?
Ndruaj se mos ësht' mbollisur
Fjala: — Jam Shqipëtar! — ..»

Pastaj ngre kryet përpjetë,
Çapin hedh me shpresë:
Kur luftohet pér një jetë
Rrugën ç'mund ta presë?

V

Çan anija përmbi valë,
Er' e detit ledhaton,
Në kuvert' Ai ka dalë
Dhe më «tapën»¹⁾ kuvendon.

Kish një emër atje shkruar
Me një ngjyr' të kuqe zjarri,
Shpesh, në jet' e kish takuar
Këtë emër — «Partizani»

Dikur vrar' e dikur prerë
Dikur tmerr edhe panik
Dhe ngado që ishte sjellur
Me të mbetur kish armik.

Dikur vrar' e dikur prerë
Dikur djegur bërë hi,
«Partizani» dhe një herë
I tha «Eja!» përsëri.

(1) Tapa në formë rrathi, që përdoren për shpëtimin e atyre që janë në rrezik të mbyten. Në to shënohet edhe emri i vaporit.

Veç këtë s'e kish menduar
Që mbi kraht' e «Partizanit»
Do të merrte i penduar
Rrug'n' e jetës drejt vatanit.

Pastaj filli i mendimit
Ç'i kaptoi si vetëtimë,
Tek një çast i kuvendimit
Atje brënda në kabinë.

E kish ftuar kapidani
Dhe me të kish kuvenduar
Atë shpirt, ku qe tufani,
Dalngadal' ja pat qetuar:

«Lere brengën, hidhja detit,
Hidhja valës që ta marrë,
O ta kredh në fund të detit,
Që askurrë të mos dalë!»

Vështroi bregun që avitej,
Atë breg që e pat lënë,
Vall' atje a do të pritej?
Dhe n'e pritshin, ç'duhej thënë?

Se n'e fali ligji, shteti
A e falnin zemrat vallë?
Kush i theu dhe prap' i gjeti
Ato zemra, për të, gjallë?

Pastaj djal' i tij motak,
Që e la kur u mërgua,
Ç'do t'i thosh për atë gjak,
Që ndër dejt ju përvëlua?...

Por sirena ja largo
Këto thika që e shponin,
Si prej gjumit shpejt e zgjoi,
Zhurm' e veshëve që gjëmonin.

Çudi!... zemra s'kish pëlcitur,
Vetëm rrihte e nxituar:
Durrsi plak i përtëritur
Po shkëlqente i praruar.

An' e detit ndryshe bërë,
Ndryshe kodrat përmbi të,
Dhe qyteti më i gjérë,
Tjetër ngjyr' e tjetër zë.

VI

Brënda portit plot flamurë,
Se ç'valonin tërë hir
Ç'ridodhë vallë, ç'ësht' kjo zhurmë?
Mos ka Durrsi panair?...

Vështron vinçat si punojnë
Krahët si gjigandë kapin,
Që nga toka diç ngarkojnë
Edhe tokës diç i japid.

* * *

Ja dhe fundi, «Partizani»
Hedh spirancën thell' në det;
Prin përpëra kapidani,
Prapa tij ai po zbret.

Po një çast i ndalet këmba.
I vjen bota rrrotulluar;
Çapin tjetër si ndër gjëmba
Po e hedh i turbulluar:

«Sigurisht ky oficer
Me nishanet lara-lara
Nuk ka dal' të m'bëjë nder,
Por të thotë — Marsh përpara!»

— Pasaportën, shok, ju lutem...
Mirse-erdhët... bëtë mirë
Ja, atje, ju pret familja,
Mund të shkoni, jini i lirë!

«Jini i lirë!... ta besonte?
I bën' veshët a dëgjoi?
Oficeri e uronte
Edhe dorën ja shtrëngoi!

* * *

Sapo hodhi çapn' e parë
Bir' e grua pa aty,
Më mirë plumbi ta kish' marrë,
Se ky zjarr nga katër sy.

Katër sy vështrojn' atë,
Katër sy nér lot mbuluar,
Katër sy dhe asnje zë
Mu në vend e kan' gozhduar.

Katër sy, po ç'forcë kanë...
Ç'gas e dhëmbkë të dërgojnë?
Kush, si ky, ata i panë
Edhe mundën t'i durojnë?

Katër sy vështrojn' atë
Me qortim e me mëshirë,
Katër sy dhe asnje zë
Lëshojn' afsh e tym si tirë.

Dhe ky çast që duhet shkuar,
Qoft' në ankth a në gëzim,
Pret sa zemra e gulçuar
Të nis' rrahjet me qetim.

Pastaj zemr' e përmalluar
Malln' e saja s'përbën dot,
Shikon njerëz përqafuar
Edhe sy që rrjedhin lot.

MBRETI DHE I BIRI

(Legjendë)

Tregojnë se një her' e mot
Një djal të vetëm kish një mbret,
Pa të ky mbret s'jetonte dot,
E ngjitur pranë tija mbet.

Për të stolirat e Persisë
Edhe suitat me taborë,
Edhe përtej prej Arabisë
Kish sjell' të bukur hamëshorë.

Veg si dashnori i verbuar
Nga xhelozia përvëlonjëse,
Ky mbret të birin pat rrethuar
Me dashurinë robëronjëse.

Dhe me festimet plot shqëlqim
Apo gostirat madhështore,
I sillte lodhje dhe mundim
Me atë jetë aq pompoze

Dhe në shërbimet e ofiqit
Ai e mbante gjithnjë pranë
Pushtet' i dhuniës, pushtet' i ligjit
Të njomën zemër ngadal ja vranë.

Se tër këto, pandehte mbreti:
«I jan' tim biri argëtim!»
Po s'pat menduar që i shkreti
Nën to rënkonte pa pushim.

As kish menduar që kjo botë
Ësht' aq e gjér' e e larmishme,
Ka shok' e miq, gëzime, lotë
Ëndra, pasione të fuqishme.

Ndaj përpëlitez i mjeri djale
(Mes asaj bote i vetmuar)
S'i mbet gëzim, ju tha çdo fjalë
Dhe erdh' u bë gjith' i trishtuar.

* * *

Kështu u nda me fëmijrinë
I dha të fundën lamtumirë,
Ku s'njohu tjatër veg vetminë,
Që vret çdo èndërr dhe dëshirë.

Po kur në të pranvera çeli
E erdh' i ndezi aq zjarr në gjë
E lodhi fort edhe e veli
Ajo e atit «dashuri».

Dhe diç kërkonte zemr' e tija
(Atë që mbreti s'e kuptonte)
Se s'ishte kjo, jo, pasuria
As bot' e ngushtë q'e rrighthonte.

Dhe s'ishte kjo as dashuria
E as kujdes' i atit mbret,
Diç tjetër ishte: nga thellësia
Ajo ngadalë po e vret.

Ndaj si një lule kur shkon vera,
Që nis e zverdhet, thahet, bie...
Ashtu dhe princit gjithngahera
I ik çdo fije gjallërie.

* * *

Ahere mbreti mjek' e të ditur
I pati thirrur dh'i pat urdhruar,
Po çdo mjekim ja pat cfilitur
Të njomën zemër të dërmuar.

U ngrys si moti, u tha si fleta,
E dalngadal' erdh' u nemit
Ndaj perëndimit i shkontejeta
Gjersa një ditë u venit.

I than' ahere të madhit mbret
«Të ftonte aksh të ditur pranë!»
Dhe erdh ai, po princin gjet
Pa shpirt, mbështjellë me savan.

«O ç'gjëm' e madhe më gjeti mua!»
Nga dhëmbja mbreti po bërtiste
«Kush vall më mbeti që ta dua?...»
Pastaj përqart zuri të fliste.

Si derdhi lotë dhe flokët shkuli
Të ishte vetëm ju duk më mirë
Ndaj obortarët i përzuri
Dhe mbeti filli me të birë.

Ja puthi buzët si mermeri,
U mat ti fliste, por nuk mundi,
Se ndjeu që diç në gjoks i theri
Edhe nga dhëmbja krejt e humbi.

* * *

Kur erdh në vete, mbret' i ngratë
Urdhroi t'ja sillnin plakun pranë
Dhe vetë prapë kryelartë
Kaloi prej atit në sovran.

— Për ty më than', i urti plak,
Të madhe dije paske shumë,
Tim bir kërkoja të shëroje
Andaj këtu të thirra unë! —

U ndal një çast. Po, për të birë
E kishte thirrur plakn' e ditur,
Andaj, me gjith' q'e pat vështirë
Prej buzve fjalë i pat rrëshqitur:

— E imja fjalë për ty ësht' ligj,
Prandaj ma thuaj të vërtetën:
Përse im bir u tret e vdiq?
Vall' ç'ja rëndoi atij jetën? —

I urti plak nuk nxori fjalë
Veç princit gjoksin e dërmuar,
Ja çau lehtë dhe ngadalë
I mori zemërën nér duar.

Edhe në heshtje veç sodit
Të princit zemër, gjith' i matur,
Pastaj me dorë kap e shqit
Një fill që zemrën kish përgjakur.

Si ndenji çaste i menduar,
Me një shikim që larg u tret,
Ashtu me zemërën nér duar
Iu këthyе të madhit mbret:

— O Madhëri, siç më urdhrove,
Do të ta them atë që di,
Me një përrallë, po më lejove,
Mendimin tim do njohësh ti:

«E muar një bilbil një herë
Edhe e kyçën në kafas,
Dhe as në dimër, as në verë
Asnjë nga shokët nuk ju qas.

Dhe duke qënë gjith' i ndryer
Ju shojt ngadalë gas e jetë
Vajtonte gjith' i mallëngjyer
Fatin e tij të zi, të shkretë.

I zoti që ma kish bilbilë
Vajtimn' ja merrte ligjërim,
E duke qënë vet' i lirë
S'mendoi kurr për të lirim

Andaj kujdes e dashuri
I shkuan të zotit krejt më kotë
Se ky bilbil si një qiri
U shojt sakaq, pa mbushur motnë.

Ta kish lëshuar përtëj kufirit
T'atij kafazi, o Madhëri,
Bilbili prapë majë blirit
Do kish kënduar me gjallëri!»

— Shiko tami filln' e mallkuar
Që ka rrëth zemrës ytë bir
Ajo e bëri të lënguar
E i xhvati jetën me pahir.

Ta kishe lënë të vraponte,
Të përqafonte të madhen botë
Atje, kjo zemër, do t'i gufon te
E filli s'do ta ndalte dot'.

Pastaj një ditë do qe këputur,
Do rrihte zemra krejt e lirë,
Ai do ishte krejt i lumtur
Dhe ti i lumtur me tëtë birë.

I heshtur mbreti tek dëgjonte
U zbeh, u zverdh si një meit
Ju njomën sytë, zu të rënkonte
Dhe me rënkim ngrysi çdo vit.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

1. Copëza jetë	3
2. Këmput tim	4
3. Atdheut	5
4. Kujtime Lavdije	6
5. Tetë Nëndori	7
6. Netë ilegale	8
7. Ikën shoqet, ikën!	9
8. Para vdekjes	10
9. Korieri	11
10. Endrat partizane — këngët partizane	13
11. Pjesë fëminije	15
12. Këngë e pambaruar	17
13. Dëshirë	18
14. Kur agojnë diejt	19
15. Përgjigje	20
16. Dëshëronja	22
17. Më fal, o nënë e dashur	23
18. Nefëve	24
19. Heshtje që pohon	26
20. Nëna	27
21. Tim eti	28
22. Si më lindi kënga e thjeshtë.	29
23. Kur agon	31
24. Perëndim	33
25. Natë	34
26. Mall	36
27. Pejsazh pranveror	38
28. Zemra ime	39
29. Kujtimet	40
30. Një zë më zgjon nga gjumi	41
31. Kur ti fle	42
32. Ty të desha mbi të gjitha dashuritë	43
33. I falem dashurisë	44
34. Pse hesht?	45
35. Vetëm ti...	46
36. Agimi të thërret	47
37. Të kërkoj ty, dashuri!	48
38. Kujtime nga motet e fëminisë	49
39. Ringjallja e një zemre	54
40. Mbreti dhe i biri	66